



Pranuar / Dorezuar Prilmenur/Prodato Received/Delivered	23.06	2022	2	vite- god- year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	3669/2022		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.422/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.422/2022 të datës 26.04.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.422/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2018 është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar për Rregullimin Ekonomik të Aeroporteve dhe Shërbimeve të Navigacionit Ajrorë” në Departamentin BNRRE të Autoritetit të Aviacionit Civil, i cili më datë 04.04.2022 me numër të referencës AACK/BNJ/TRN ka parashtruar kërkesën tek Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil për aprovim për trajnim profesional “Teknikat e Auditimit”, i cili trajnim do të mbahet me datë 10-13 Maj 2022. Më datë 06.04.2022 Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore i kthen përgjigje ankuesit se për të njëjtën çështje janë duke pritur përgjigje nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil i Kosovës ngase ankuesi e ka njoftuar të njëjtën se ka parashtruar ankesë në Këshill ne vitin 2021, ne kohen kur Këshilli ka qenë jo funksional.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigje me Udhëheqësen e Njesisë së Burimeve Njerëzore, me datë 26.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nëpërmjet e-mail-it zyrtarë ankesa.kpmschck@rks-gov.net me numër të protokollit 2405/2022 me pretendim ankimor kundër refuzimit të trajnimit profesional.

Me datë 08.06.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas kërkesës së Kryetares së Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit *nxjerr vendimin VK.nr.53/2022 për zgjatjen e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune për ankesën me numër A.nr.422/2022 të datës 26.04.2022.*

Me datë 15.06.2022 ankuesi bënë plotësimin e ankesës pas pranimit të kërkesës për plotësim të ankesës së datës 14.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me ç'rast ankuesi e njofton Këshillin se trajnimi i radhës për "Teknikat e Auditimit", ofrohet me datë 09-12 gusht 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.05.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil. Autoriteti i Aviacionit Civil më datë 20.05.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/94.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 26.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.06.2022 për zgjatje të afatit; Plotësimi i ankesës i datës 15.06.2022; Prova shtesë e datës 10.06.2022; e-mail i datave 22.03.2021, 19.03.2021, 17.03.2021, 16.03.2021; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 28.06.2020; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 27.05.2021; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 29.07.2021; E-mail i datave 30.07.2021, 29.07.2021, 28.06.2021, 24.06.2021, 09.08.2021, 02.08.2021, 10.08.2021, 31.08.2021, 03.09.2021, 21.04.2022, 14.04.2022, 06.04.2022; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 13.05.2022; Lista e trajnimeve e ankuesit; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 04.04.2022; Letër përcjellëse e datës 20.09.2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-mail i datave 22.10.2021, 22.10.2021, 19.10.2021, 18.10.2021, 28.09.2021, 27.09.2021; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 27.09.2021; Ankesa e ankuesit e datës 09.09.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i ankuesit; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Plani i trajnimeve për vitin 2021; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 28.06.2020; Kërkesa për aprovim të trajnimit profesional i datës 29.07.2021, e-mail i datës 02.07.2021; Plani i trajnimeve për vitin 2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore *për përfundim të procedimit administrativ* e filluar me ankesën me numër A.nr.422/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, gjenë së ankuesi me datë 26.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2405/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor kundër refuzimit të trajnimit profesional të datës 04.04.2022 për trajnimin "Teknikat e Auditimit" i cili trajnim do të mbahet nga data 10

deri me 13 Maj 2022, ndërsa sa i përket kërkesës për plotësim të ankesës të datës 15.06.2022 ankuesi e ka njoftuar Këshillin se trajnimi i radhës mbahet nga data 09-der me 12 Gusht 2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.04.2022 lidhur me refuzimin e kërkesës së datës 04.04.2022 për trajnimin "Teknikat e Auditmit" i cili trajnim është planifikuar të mbahet nga data 10 deri me 13 Maj 2022, atëherë konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kështu në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Procedura administrative përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën me numër A.nr.422/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.422/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqëses së Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

